

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**MINISTRISË SË KULTURËS**

**DHE**

**UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**PËR**

**IMPLEMENTIMIN E DOKUMENTIT**

**“PAKTIT PËR UNIVERSITETIN”**

Tiranë, më 8 . 05 .2019



**Ministria e Kulturës**, e përfaqësuar nga Ministrija znj. Elva Margariti, më poshtë e referuar si **“Ministria”**,

nga njëra anë,

dhe

**Universiteti i Arteve**, i përfaqësuar nga Rektori z. Kastriot Çausi, më poshtë i referuar si **“Universiteti”**

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si **“Palët”**.

**Duke pasur në vëmendje se:**

- ❖ Masat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare mbi Dokumentin “Pakti për Universitetin” kanë qëllim plotësimin e angazhimeve të identifikuara gjatë procesit të dialogut për të krijuar zgjidhje më të mira brenda fokusit të fushës së veprimit të palëve;
- ❖ Ministria e Kulturës ka në fushën e përgjegjësisë së saj hartimin dhe bashkërendimin e punës për politikën në fushën e artit e të kulturës, nëpërmjet edukimit të popullsisë, rijetëzimit të vlerave e të trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal;
- ❖ Universiteti i Arteve është institucion publik i arsimit të lartë me karakter artistik në Shqipëri, që ofron diplomë Universitare në Muzikë, Arte të Bukura, dhe Art Skenik. Qëllimi kryesor i tij është të ofrojë arsimim të lartë profesional dhe veprimtari krijuese në fushën e artit dhe të kulturës, të thellojë kualifikimin profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e të kulturës, si dhe të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit;
- ❖ bashkëpunimi i ngushtë i palëve do të sjellë zhvillimin progresiv të artit dhe kulturës duke promovuar kapacitete të reja krijuese dhe artistike

**Bien dakord për sa më poshtë:**

Neni 1



### **Qëllimi dhe objekti**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është krijimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve me qëllim dhe në funksion të zbatimit sa më të suksesshëm të ‘Paktit për Universitetin’, duke përcaktuar rregulla, përgjegjësi dhe detyrime konkrete për secilën nga palët.

Objekti i rregullimit të kësaj marrëveshje është përcaktimi i detyrimeve respektive të palëve nënshkruese.

### **Neni 2**

#### **Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve**

Palët ka detyrime dhe të drejta, si më poshtë:

1. Palët ngrenë Grupet ndërinstitucionale të punës të dedikuar për koordinimin e punës me Universitetin për koordinimin e punëve për implementimin e dokumentit “Pakti i studentëve;
2. Ministria mbështet Universitetin me pjesëmarrjen e specialistëve të Institutit të Monumenteve të Kulturës në vlerësimin e problematikave infrastrukturore si dhe të bashkërendojë punën me institucionet e tjera shtetërore;
3. Ministria angazhon institucionet e saj të varësisë në fushën e artit dhe kulturës për të krijuar bashkëpunimet në nivel institucional me departamentet e ndryshme të Universitetit sipas specifikave për platforma dhe programe për studentët;
4. Palët bashkëpunojnë me Universitetin gjatë zhvillimit të konceptit dhe hartimit të projekteve të ndryshme për të cilat palët bien dakord që do ti bashkërendojnë;
5. Ministria ndihmon universitetin për ngritje fondesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

### **Neni 3**

#### **Koordinimi ndërmjet Palëve**

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Si rregull, komunikimi kryhet në formë shkresore, por edhe format e komunikimit elektronik.
2. Grupet e punës së ngritura nga palët hartojnë plane pune konkrete sipas tematikës së problematikave për tu zgjidhur me direktiva konkrete për zbatimin e tyre nga palët. Ky plan pune miratohet nga titullarët e palëve në këtë marrëveshje.
3. Në zbatim të kësaj marrëveshje, palët me autorizim caktojnë nga një person kontakti që është përgjegjës për komunikimin ndërmjet palëve.



4. Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm, do të organizojnë takime të grupeve të punës, institucioneve specifike, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni, dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.
5. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

#### Neni 4 Ndryshimet

Çdo ndryshim i rënë dakord nga Palët bëhet me shkrim dhe është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje. Çdo ndryshim i tillë hyn në fuqi sipas procedurës së përcaktuar në nenin 5.

#### Neni 5 Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme për t'u zbatuar nga palët nënshkruese të kësaj marrëveshje deri në datën zyrtare të përfundimit të zbatimit të 'Paktit të studentët' ose kur palët vendosin të ndërpresin bashkëpunimin.
2. Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje në gjuhën shqipe.

E nënshkruar për dhe në emër të "Ministrit", në Tiranë, në datën 8.05.2019  
nga

**Znj. Elva Margariti**  
Ministër  
Ministria e Kulturës



E nënshkruar për dhe në emër të Universitetit të Arteve, në Tiranë, në datën 8.05.2019  
nga

**Z. Kastriot CAUSHI**  
Rektor  
Universiteti i Arteve

